



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Nr. 4049/3 Prot.

Tiranë, më 31.7.2024

Lënda: Për ndjekje dhe kompetencë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓  
Rruga "Naim Frashëri", Nr.37  
Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Rruga "Aleksandër Moisiu", përballë IKV-së  
Tiranë

Në përgjigje të shkresës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar me nr. 533 prot., datë 21.06.2024, me lëndë: "Për miratimin e programeve mësimore për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të orientuar me drejtim artistik" regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), me nr. 4049 prot., datë 25.6.2024, bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 367, prot., datë 18.07.2024, "Për miratimin e programeve mësimore të kurrikulës artistike, të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë dhe programeve mësimore të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Gola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

## **KURRIKULA ARTISTIKE**

**Programet e degës: BALET**

**Specialiteti: Kërcimtar profesionist/balerinë**

**Për klasat: X-XII**

**Tiranë , 2024**



## **I. HYRJE**

Baleti është një mënyrë e veçantë kërcimi në skenë nëpërmjet hapave të lëvizjes, muzikës, skenografisë dhe veshjeve, duke na treguar një histori, si dhe përndez imagjinatën e spektatorëve. Që të bësh lëvizje të përkryera, duhet të ushtrohemi gjatë e, megjithatë, baleti i zbavitë pa masë ata që e ushtrojnë dhe i mahnitë ata që e soditin. Baleti, së bashku me mësimin e llojeve të tjera të kërcimeve është objekt i një zhvillimi të specializuar e profesional, e cila kërkon një vemendje të posaçme edhe ndaj dokumentacionit bazë dhe përdorimit të tij në procesin konkret të artit të lëvizjes. Kjo e bën të domosdoshëm zhvillimin e dokumenteve kryesore sikurse është edhe kurrikula artistike bazuar në lëndë, ku do të përfshiheshin detyrimisht udhëzimet e nevojshme që nga përmbajtja koreografike, por edhe ajo muzikore, historike, duke u mbështetur në metodologjitë dhe vlerësimin e nxënësve në çdo nivel dhe cikël.

Në një kuadër të tillë, hartimi i kurrikulës artistike për mësuesit e degës “Balet” është menduar të jetë një udhërrëfyes i përgjithshëm për të orientuar lëndët teorike artistike, teorike - praktike dhe specialitetin e “Mjeshtërisë së kërcimit klasik” për çdo klasë, nivel dhe cikël shkollor për të bërë të mundur unifikimin dhe orientimin e të gjitha përmbajtjeve mësimore artistike përmes tematikave, metodologjive dhe vlerësimit në gjatë procesit mësimor.

## **II. QËLLIMET E ARSIMIT, DEGA “BALET”**

Kurrikula artistike në degën “Balet” ka si qëllim të formojë nxënësit në të dyja kulturat: kulturën teorike-artistike-profesionale dhe kulturën e përgjithshme, duke i përgatitur ata për sukses në tregun e punës dhe për një jetë të suksesshme në përgjithësi. Me një mision të qartë dhe një vizion përpara, ne synojmë të jemi një qendër e shquar e zhvillimit artistik dhe profesional të të rinjve në fushën e baletit.

Kjo degë kërkon të ofrojë një mësimdhënie të përshtatur sipas kërkesave por edhe duke iu ofruar interesave të nxënësve dhe aftësive apo talenteve në zhvillimin profesional të tyre në fushën e baletit dhe kërcimit. Kurrikula artistike në degën “Balet” krijon një mjedis mësimor frytdhënës, ku nxënësit mund të zhvillojnë pasionin e tyre për kërcimin duke eksploruar potencialin e tyre artistik.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj synon të sigurojë:

- Mundësi për të gjithë nxënësit për të zhvilluar kompetencat profesionale artistike të kërcimit, duke i bërë bazë njohurive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave të mjaftueshme për t'u integruar në punësim apo për të vazhduar studimet e tyre profesionale artistike në nivele më të avancuara.
- Mbështetje për të rritur disiplinën, aftësitë sipërmarrëse dhe për të përhapur vlerat estetike.
- Njohuri të thella të rregullave dhe praktikave të kërcimit profesional artistik, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për të studiuar dhe punuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Mbështetje për zhvillimin psikologjik dhe fizik të nxënësve tanë, duke i përgatitur ata për sfidat e veprimtarive të tyre të ardhshme profesionale artistike.
- Mjedis mbështetës për të zhvilluar përgatitjen fizike dhe psikologjike, duke përgatitur nxënësit për të përballuar sfidat dhe rreziqet që mund të hasin në karrierën e tyre artistike.
- Përdorimi dhe njohuri mbi teknologjitë dhe metodologjitë bashkëkohore që lidhen me praktikën e kërcimit, për të përmirësuar nivelin e tyre artistik dhe profesional.
- Orientim dhe njohuri mbi rregullat dhe praktikën profesionale artistike të kërcimit, përfshirë sigurinë dhe standardet ndërkombëtare në mjedisin e punës.
- Promovimi i frymës së tolerancës dhe bashkëpunimit, duke u bazuar në përvojën e punës dhe ndarjen e përvojave në mes nxënësve.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj deri në fund të shkollimit kërkon të zhvillojë te nxënësit kompetenca të përgjithshme artistike. Në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit do të zotërojnë disa **kompetenca kryesore artistike**.

- **Komunikimi:** në mënyrë korrekte, mbi artin e kërcimit, duke shprehur mendimet dhe ndjenjat apo duke argumentuar qëndrimet e tyre për çështje të ndryshme profesionale artistike.

- ***Përdorimi i burimeve dhe teknikave:*** për të mbledhur dhe për të shfrytëzuar informacionet e nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik.
- ***Zhvillimi i potencialit të brendshëm:*** në kërkim të zgjidhjeve të reja efektive dhe krijuese.
- ***Angazhimi dhe përkushtimi:*** fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin artistik, personal dhe shoqëror.
- ***Respektimi i rregullave dhe parimeve demokratike:*** për një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe globale.
- ***Vetëkontrolli:*** gjatë zhvillimit të veprimtarive të tyre artistike, duke menaxhuar kohën dhe burimet në mënyrë efektive.
- ***Pjesëmarrja dhe vazhdimi i të nxënësve:*** duke shfaqur gadishmërinë dhe vullnetin për të mësuar gjatë gjithë jetës së tyre.
- ***Bashkëpunimi dhe respekti ndaj të tjerëve:*** duke bashkëpunuar aktivisht në arritjet e tyre si profesionistë artistikë, duke vlerësuar dhe respektuar kontributet e të tjerëve.
- ***Vlerësimi dhe vetëvlerësimi:*** duke i përdorur ato për të përmirësuar dhe për të avancuar në arritjet e tyre profesionale dhe artistike.

Dega “Balet” dhe kurrikula e saj deri në fund të shkollimit kërkon të zhvillojë te nxënësit kompetenca të përgjithshme artistike. Në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit do të zotërojnë disa ***kompetenca specifike artistike***.

- ***Ekzekutimi i klasës së baletit klasik:*** zhvillojnë njohuri të thella duke praktikuar ushtrimet përkatëse të levës, mesit të sallës dhe hedhjeve (Allegro saute), apo praktikimin e teknikës në puante për vajzat.
- ***Interpretimi i formave të ndryshme të kërcimit:*** të shkëputura nga baletet klasike si Pas des Deux, Pas de Trois, Pas de Six, Pas de Quatre, Pas d'Action, Marsh, Valse Mazurka, Polka, kërcime hungareze, spanjolle etj., duke i përshtatur ato sipas përmbajtjeve tematike të lëndëve të ndryshme të kërcimit.
- ***Interpretimi i teknikave dhe stileve të kërcimeve bashkëkohore:*** duke shfaqur njohuri të thella dhe aftësi në përdorimin e tyre.

- *Interpretimi i valleve popullore*: të trevave të ndryshme të Shqipërisë, duke i trajtuar ato me respekt dhe autenticitet.
- *Organizimi i procesit të të nxënësve*: në një mënyrë të përshtatshme dhe efektive, duke përfshirë një formim të përgjithshëm profesional artistik dhe teoriko-praktik.
- *Klasifikimi i llojeve të kërcimeve*: duke i shqyrtuar ato në aspekte si lëvizje, periudha, përmbajtje, tema, stile, metoda, teknika, dhe të tjera.
- *Qëndrimi estetik*: ndaj veprave të ndryshme koreografike, duke i analizuar ato dhe duke i vlerësuar për karakteristikat dhe veçoritë e tyre.
- *Analiza dhe vlerësimi*: ndaj problemeve artistike, duke mbajtur një qëndrim profesional artistik.

### **III. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR SPECIALITIN “MJESHTËRI E KËRCIMIT KLASIK”**

III.1 Mjeshtëri e kërcimit klasik - vajza

III.2 Mjeshtëri e kërcimit klasik - djem

### **IV. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE**

V.1. Histori baleti shqiptar

V.2. Folklor shqiptar

V.3. Histori baleti botëror

V.4. Histori muzike

V.5. Anatomia e kërcimit

### **V. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT E TJERA ARTISTIKE**

VI.1. Duet klasik

VI.2. Repertori skenik

VI.3. Ushtrime të karakterit botëror

VI.4. Balet Modern

VI.5. Valle popullore

## **VI. UDHËZIME METODIKE TË PËRGJITHSHME**

### **VI.1. PËR LËNDËN “MJESHTËRI E KËRCIMIT KLASIK”**

Kjo lëndë zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve në klasë (vajza dhe djem) me shoqërim muzikor në piano.

Për arritjen e nivelit sa më optimal në lëndën mjeshhtëri kërcimi klasik, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë kërkuese dhe e njëtrajtshme për të gjithë elementët në levë, mes *salle*, *allegro* dhe *puante*. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko-emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, me qëllim që të kemi rezultate sa më të larta.

Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisë shkallën e të nxënësve dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij lidhur me programin, me nxënësit që e përvetësojnë atë më shpejt. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programit tematik.

Pavarësisht numrit të nxënësve në klasë në lëndët artistike profesionale, klasat punojnë të ndara në grupe (djem) (vajza) sepse programi i lëndëve artistike praktike për të dy gjinitë është i ndryshëm.

## VI.2. PËR LËNDËT E TJERA ARTISTIKE TË KËRCIMIT

**Dueti klasik:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve e shoqëruar me piano dhe bazuar në elementet teknike të kërcimit duet dhe kombinacionet duhet të jenë të vendosura në logjikën e radhës, të ekzekutohen pa u nxituar së tepërmi, me qëllim që çdo shembull *padjerzhke* të kuptohet qartë.

Përveç njohjeve dhe ekzekutimit të shembujve teknikë të *padjerzhkave*, partnerët, në çdo pjesë, duhet të dinë momentin se ku ndodhen, pozicionin e vet, që nga pozat organike në kombinim me pozat e partnerëve, me shprehje estetike e skulpturale. Të gjitha kombinacionet ekzekutohen me njëri dhe me tjetrin këmbë, gjithashtu, në anën e djathtë dhe në anën e majtë.

**Repertori skenik:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve e shoqëruar me piano.

Përmes këtij programi fillon njohja e nxënësit me format e kërcimit të baletëve klasike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet anës teknike dhe artistike të mësimin. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psiko- emocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i mësimin me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënësve dhe rendimentin e orës së mësimin. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimin të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programin, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Ushtrimet ose lëvizjet duhet t'i përgjigjen programin tematik.

**Ushtrime të karakterit botëror:** zhvillohet e ndarë në dy grupe nëse klasa është më shumë se 25-të nxënës shoqëruar në piano. Në klasën X ndodh njohja e parë e nxënësve me disiplinën e kërcimit botëror.

Gjatë klasës X mësohen elementet kryesore të kërcimeve më të njohura skenike, si: tarantela, hungareze, ruse dhe spanjolle.



Në klasën XI mësohen lëvizje më të vështira në levë dhe në mesin e sallës, gjithashtu ndërtohen dhe etyde më të gjata dhe më të vështira që kanë për qëllim zhvillimin e koordinimit të lëvizjeve.

Në klasën XII fillon mësimi i vendosjeve të ndryshme që kanë partnerët në kërcim dhe mësohet marrëdhënia e partnerëve gjatë kërcimit. Gjithashtu, vështirësohen etydet e ndërtuara në bazë të lëvizjeve të valleve hungareze, polake, ruse, italiane dhe spanjolle, të ndërtuara 32 – 64 masa muzikore. Gjatë këtij viti përvetësohet teknika e hedhjeve dhe e rrotullimeve në çift.

Gjatë klasës XII ndryshon dhe struktura e mësimit. Pjesa më e madhe e mësimit zhvillohet në mesin e sallës. Në levë mësohen vetëm ato lëvizje që mund të paraqesin vështirësi në zhvillimin në mesin e sallës.

**Baleti modern:** zhvillohet e ndarë në grupe pavarësisht numërit të nxënësve në klasë. nxënës/i,-ja drejtohet drejt një disipline të re, të pavarur nga baleti klasik, dhe njëkohësisht disiplinë ndihmëse kryesore e teknikës klasike. Baleti kontemporan u jep nxënësve nëpërmjet teknikave të tij një lëvizje të gjerë emocionalisht dhe teknikisht. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënësve e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Kjo lëndë zhvillohet në grupe vajza dhe djem me shoqërim muzikor në Cd. Për realizimin e këtij programi, mësuesi mbështetet në teknikat bashkëkohore të kërcimit.

**Valle popullore:** zhvillohet në grupe pavarësisht numrit të nxënësve e shoqëruar me piano ose fizarmonikë. Lënda “Valle popullore” për nxënësit e shkollës së mesme është një nga lëndët më të rëndësishme për edukimin e nxënësve me shprehitë e valles sonë popullore dhe asaj të kultivuar skenike. Përvetësimi i shprehive plastike të valles sonë popullore është baza nga ku nxënësi do të interpretojë artin koreografik të kultivuar me frymë të theksuar kombëtare. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit jo vetëm që mësojnë morfologjinë e kërcimit popullor, por dhe

përmbajtjen e pasur të traditës së popullit tonë që nëpërmjet valles ka ditur të shprehë botën e tij shpirtërore. Repertori i valles popullore përfshin valle tradicionale burimore dhe valle të përpunuara të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve Popullore, duke pasur parasysh vallet me leksik të kristalizuar si shembuj më të mirë të lëvizjes koreografike.

*Shënim:* Pavarësisht numrit të nxënësve në klasë në lëndët artistike , klasat punojnë të ndara në grupe (djem) (vajza) sepse programi i lëndëve artistike praktike për të dy gjinitë është i ndryshëm.

Lënda e specialitetit dhe lëndët artistike të kërcimit ndahen në grupe edhe kur numri i nxënësve është më pak se 4(katër), dhe në lëndët teoriko-artistike klasa ndahet në grupe kur është më shumë se 15 nxënës.

### **VI.3. PËR LËNDËT TEORIKE**

Nëpërmjet programit të **“Histori baleti shqiptar”** nxënësi duhet të zhvillojë aftësi për të:

- shpjeguar *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik shqiptar dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga vitet 50 të shek. XX deri në ditët e sotme;
- analizuar veprat (baletet) shqiptare;
- kategorizuar baletet sipas periudhave;
- përcaktuar temat që u trajtuan në baletet shqiptare nga koreografët ;
- vlerësuar duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshmekoreografike.

**Folklori shqiptar** nxënësi duhet të zhvillojë aftësi për të:

- analizuar zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si: *karakterin, mënyrat e të kërcyerit sipas llojeve, ritmet, kostumet popullore* që përbëjnë folklorin tonëkoreografik;

- gjetur shembujt folklorikë koreografikë përmes interpretimit, ritmeve, melodive, karaktereve, duke shpjeguar *qartë* rrugët e krijimit;
- zhvilluar aftësitë duke rritur interesin në vallet folklorike, si dhe duke shpjeguar *saktë* tiparet e valleve, karakterin folklorik etj.;
- trajton vlerat e folkloritkoreografik;
- dhënë shpjegime duke sjellë shembuj konkretë të folklorit koreografik nga treva tëndryshme

**Histori baletit botëror** nxënësi duhet të zhvillojë aftësi për të:

- Shpjeguar *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme.
- Analizuar *shumë saktë* veprat (baletet) botërore.
- Kategorizuar *saktë* baletet sipas periudhave.
- Përcaktuar *saktë* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo dëmi klasik.
- Vlerësuar *saktë* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

**Histori muzike** nxënësi duhet të zhvillojë aftësi për të:

- Prezantuar dhe ilustruar me CD/DVD gjatë procesit mësimor kryevepra të kompozitorëve.
- Shikuar i shfaqje të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare në vendin tonë.
- Kërkuar nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për vepra skenike të pasqyruara në ëebsite të ndryshme apo në YouTube.
- Kërkuar për njohjen më të mirë të muzikës në parahistori dhe antikitet nëpërmjet zbulimeve arkeologjike .
- Kërkuar në galeri arti për lidhjen e arteve të bukura me muzikën.

**Anatomi e kërcimit** nxënësi duhet të zhvillojë aftësi për të:

- përvetësuar njohuritë e reja mbi trupin e kërcimtarit, muskulaturën dhe i përdorin këto njohuri në praktike të ndihmuar prej mjeteve

teknologjike.

- zbatuar zgjidhje të problemit të lëvizjes duke u ndihmuar nga njohja e ndërtimit trupor,
- realizuar projekte kurrikulare, në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra në lidhje me anatominë dhe kërcimin, si edhe t'i gërshetojnë këto njohuri me njohuritë praktike të kërcimit.
- përvetësuar njohuritë mbi proporcionet fizike të njeriut { sipas njeriut Vetruvian të Da Vincit } dhe si ti përdorin ato në balet
- zhvilluar kreativitetin dhe të menduarit kritik për zgjidhjen e problemeve.
- vlerësuar e rëndësisë se lëndës Anatomi kërcimi, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë për ruajtjen e shëndetit.
- punuar në grup ose në dyshe jep mundësi për debat ose konsultim, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të informacioneve.

## VII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në shkollën artistike dega “Balet” është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet, mbi bazë të kriterëve të caktuara, për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit të *kryerjes së performancës artistikes*, në kërcime të ndryshme. Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm që tregon rezultatet e arritura të nxënësve të programit artistik. Ky vlerësim, përfshin gjykimin për arritjet artistike të nxënësve nëpërmjet performancës të programit. Qëllimi kryesor i vlerësimit në degën “Balet” është:

- Të sigurojë informacion të plotë për arritjet e nxënësit në shkollë dhe në fushën e tij të specialitetit.
- Të sigurojë informacion për shkallën e realizimit të rezultateve të pritshme të të mësuarit.
- Të motivojë nxënësit për arritje më të larta.

Për të realizuar qëllimin e tij vlerësimi duhet të jetë: a) i drejtë/i paanshëm/i ndershëm dhe b) i plotë/objektiv. *Paanshmëria/ndershmëria* e vlerësimit garantohet nga përdorimi i kriterëve të unifikuara për vlerësimin e nxënësit (nivelet e përcaktuara e të miratuara të arritjeve).

**Plotësia e informacionit** për arritjet e nxënësit (artistike) garantohet nga format e ndryshme e të larmishme të të vlerësimit që përdoren dhe duhet të përdoren në shkollë (kryesisht përmes formimin e aftësive dhe shprehive teknike të kërcimit; zotërimin e elementeve teknik, elementeve artistik dhe emocional të lëvizjeve; zhvillimit të aftësisë interpretative dhe performimit artistik me individualitetit krijues, etj.)

Është detyrë e shkollës dhe e mësuesit që të garantojë kushtet e përshtatshme dhe motivuese të të mësuarit, duke e trajtuar procesin e vlerësimit si pjesë e procesit të të mësuarit dhe të mësimdhënies. Për këtë arsye, mësuesi duhet të planifikojë dhe të ndërtojë situata të mësuarit që u japin mundësi nxënësve të realizojnë objektivat e kurrikulës dhe ato personale në fushën e formimit artistik si dhe t'u japë atyre mundësinë për të demonstruar shkallën e arritjes së këtyre objektivave.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore dhe kriteret e vlerësimit, siguron kriteret e vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me njohuritë apo performancën muzikore të nxënësve. Vlerësimi do të zhvillohet duke u bazuar në udhëzimin me nr **protokolli 1911/1, Nr 9, datë 21.03.2023** si më poshtë vijon.

Lënda “Mjeshtëri e kërcimit klasik”

Nga klasa 10-12 programi mësimor do të realizohet në dy periudha: Shtator - Janar dhe Shkurt - Qershor.

- Vlerësimi kryhet me notë nga mësuesi i specialitetit, si dhe përmes kontrolleve teknike dhe saxhove.
- Ky specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 2 saxho.
- Çdo specialitet duhet të realizojë përgjatë çdo periudhe 1 saxho, dmth 2 saxho në vit.
- Vlerësimi në këtë klasë do të jetë i vazhdueshëm nga mësuesi i specialitetit.
- Në fund të periudhës së (II) nxënësi zhvillon provimin përfundimtar (saxho) .

*Shënim:* Vlerësimi i nxënësve kryhet nga një komision, i cili përbëhet nga mësues të të njëjtit ekip lëndor. Vlerësimi i nxënësve në saxho bëhet nga komisioni ku është i përfshirë dhe mësuesi i lëndës , i cili ka të drejtën e një note. ***Në rast se nxënësi ka kontestim note , ngrihet një komision tjetër vlerësues .*** Në provimin përfundimtar (saxho) nxënësit e klasës së XII-të, vlerësohen nga komisioni përzgjedhës. Në provimin përfundimtar të specialitetit (saxho) dhe provimit të formimit teorik praktik nxënësit e klasës së XII-të , vlerësohen nga komisioni përzgjedhës i IA-së .Disa kritere matës që ky komision duhet të mbajë parasysh janë:

- Impostimi
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët e levës,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët mesit të sallës,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët allegro ,
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët teknikë mashkullore
- Arritjet teknike dhe artistike në elementët në punate për vajzat
- Arritjet e teknikës dhe plastikës në kërcimin modern
- Aftësia në kërcimin me partner vajzë / djalë
- Aspekti fizik (pesha)
- Koordinimi
- Interpretimi/ muzikaliteti

## **VIII. TË NDRYSHME**

Kërkesat dhe kushtet e pranimit të nxënësve në arsimit të mesëm të orientuar artistik në shkollën e Baletit.

### ***Aftësitë fizike:***

- Nxënësit duhet të kenë aftësi fizike të mira dhe fleksibilitet të lartë për të përshtatur tek teknikat dhe shfaqjet e baletit.

- Aftësi për të përshtatur dhe për të përballuar sfidat fizike të teknikave të baletit si shpërndarja e peshës, fleksibiliteti, dhe koordinimi.

#### ***Aftësitë mendore dhe emocionale:***

- Nxënësit duhet të jenë të motivuar dhe të angazhuar për të mësuar dhe për të arritur sukses në fushën e baletit.
- Aftësi për të menaxhuar stresin dhe për të punuar në një mjedis konkurrues.
- Demonstrim i një qëndrimi pozitiv dhe të qëndrueshëm emocional në ballë të sfidave të performancës dhe të zhvillimit artistik.

#### ***Vlerësimi i aftësive artistike:***

- Nxënësit duhet të demonstrojnë një talent natyral për baletin, si stil, sharm dhe interpretim artistik.
- Një portofol në të cilin përfshihen rezultatet e konkursit,.

#### ***Kualifikimi akademik:***

- Për nxënësit nga arsimi bazë, duhet të kërkojmë një nivel të lartë të suksesit akademik në lëndët themelore si baleti klasik, matematika dhe gjuha shqipe.
- Për nxënësit e talentuar i jepet shanci dhe mundësia nxënësve të cilët njohin programet e lëndëve praktike artistike të zhvilluar në arsimin bazë
- Për nxënësit e huaj, pranimi kushtëzohet nga përputhshmëria e programit të studimit në shkollën e baletit me atë të shkollës së tyre të mëparshme.

#### ***Intervistë dhe konkursi: Me komision artistik të ngritur nga drejtorja e shkollës***

- Intervista dhe konkursi janë pjesë e procesit të pranimin për të vlerësuar aftësitë, motivimin, dhe interesin e nxënësve për të studiuar baletin.

#### **Kompetencat e përgjithshme artistike të nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm të orientuar artistik**

- Përmirësimi i aftësive komunikuese për të shprehur mendimet dhe ndjenjat në lidhje me artin e baletit.
- Zhvillimi i aftësive për të përdorur burime të ndryshme për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë artistike.

- Fokusimi në zhvillimin e potencialit artistik personal dhe në gjetjen e zgjidhjeve inovative në performancën e baletit.
- Demonstrimi i përkushtimit fizik, mendore dhe emocional në praktikimin dhe performancën e artit të baletit.
- Respektimi i rregullave dhe vlerave të një bashkëjetese demokratike në kontekstin e grupit dhe shoqërisë artistike.
- Demonstrimi i vetëkontrollit dhe angazhimit në përmirësimin e vetës në mënyrë të vazhdueshme.
- Përfshirja aktive në procesin e mësimin dhe bashkëpunimi në grup për të arritur sukses profesional.
- Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i arritjeve artistike për të përmirësuar performancën dhe për të avancuar në karrierën si balerin/ë.

### **Kompetencat specifike profesionale artistike të nxënësve**

#### ***Balerin Klasik***

- Ekzekutojnë klasa baleti duke përfshirë ushtrimet përkatëse të levës, mesit të sallës dhe hedhjeve (Allegro saute), për vajza dhe puante.
- Interpretimi i formave të ndryshme të shkëputura nga baletet klasike si: Pas des Deux, Pas de Trois, Pas de Six, Pas de Quatre, Pas d'Action, Marsh, Valse Mazurka, Polka, kërcim hungarez, spanjoll etj., sipas përmbajtjeve tematike të lëndëve të kërcimit.
- Demonstrimi i teknikës së puantit me precizion dhe elegancë, duke përdorur forcat e nevojshme për të qëndruar.
- Përshtatja dhe interpretimi i muzikës klasike në performancën e tyre, duke i dhënë jetë veprave klasike të baletit përmes lëvizjeve dhe ekspresionit artistik.
- Përdorimi i mimikës dhe ekspresionit fytyrës për të komunikuar emocione dhe narrativa nëpërmjet performancës së tyre.
- Demonstrimi i forcës dhe elegancës në çdo lëvizje, duke shfaqur një qëndrim të rëndësishëm dhe profesional në skenë.
- Krijimi i një lidhje të fortë artistike me partnerin në Pas des Deux dhe Pas de Trois, për të shfaqur harmoninë dhe sinkronizimin e duhur në performancën e tyre.

#### ***Balerin Modern***

Interpretimi i teknikave dhe stileve të ndryshme të kërcimeve bashkëkohore, duke përfshirë:



- Ekspresionin abstrakt dhe narrativ nëpërmjet lëvizjeve dhe pozicionimeve të ndryshme trupore.
- Përdorimi i teknikave të improvizimit dhe shprehjes së lirë për të shfaqur emocionet dhe ide të ndryshme.
- Integrimi i elementeve të artit të bashkëkohshëm, përfshirë muzikën, dizajnin, dhe shfaqjen multimediale në performancën e tyre.
- Ndërtimi i koreografive origjinale ose interpretimi i koreografive të njohura bashkëkohore, duke zbatuar një qasje të re dhe origjinale në shfaqjen e tyre.

### ***Kërcimtar Popullor***

- Interpretimi i valleve popullore të trevave të ndryshme të Shqipërisë me njohuri të thella të trashëgimisë kulturore dhe traditave të kërcimit.
- Përdorimi i kostumeve tradicionale dhe aksesoreve për të përforcuar autenticitetin dhe shfaqjen e identitetit kulturor në performancën e tyre.
- Demonstrimi i teknikave të kërcimit popullor me ritme dhe lëvizje karakteristike të përdorura në kërcimet tradicionale shqiptare.
- Interpretimi i historive dhe narrativave të përcjellura në vallet popullore, duke shfaqur emocionet dhe ngjarjet kulturore përmes lëvizjeve dhe ekspresionit artistik.
- Bashkëpunimi me grupin dhe përdorimi i koordinimit të grupit për të paraqitur vallëzimet tradicionale me harmoni dhe sinkronizim të duhur.
- Nxitja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore shqiptare nëpërmjet performancës së tyre, duke mbajtur gjallë traditat dhe vlerat e kërcimit popullor në kulturën bashkëkohore.

1. Mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të shkollës së Baletit.

Nxënësit në Arsimin e Mesëm të Lartë për tu përgatitur për tregun e punës në fund të çdo viti shkollor realizojnë dy javë praktikë mësimore profesionale në TKOBAP, në teatro apo akademi homologe prestigjioze jashtë vendit.

Mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të shkollës së Baletit.

Përfundimi me sukses i shkollës së mesme me drejtim të orientuar artistik, specialiteti "Kërcimtar", i pajis nxënësit me "Diplomën dhe Certifikatën" e përfundimit të shkollimit. Ky nivel dijes krijon hapësirë për:

- a) *Konkurrencë në fushën e artit*: Nxënësit kanë mundësinë të konkurrojnë për pozicionet e shumëllojshme në institucione prestigjioze si Teatri Kombëtar i Operas dhe i Baletit, Ansambli Popullor, trupa televizive, si dhe në kompani private të kërcimit, brenda dhe jashtë vendit (Pa patur nevojë të vazhdojë ciklin e lartë).
- b) *Vazhdimi i studimeve të larta*: Nxënësit kanë mundësinë për të ndjekur studime të larta në fushën e tyre profesionale në Universitetin e Arteve, në degën e "Koreografisë", si dhe në degë të tjera të interesit të tyre.
- c) *Diplomën e maturës*, hap dyert për debutim në skenat më prestigjioze botërore.

## IX. TEMATIKAT DHE REZULTATET E TË NXËNIT PËR LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE

Dega: BALET

Lënda: Histori baleti shqiptar

Klasa: 10

Tematika	Rezultatet e të nxënit
<b>Baleti në gjysmën e dytë të shekullit XX</b>	<i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe vlerëson përmes njohurive të mëposhtme:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Koreografinë shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, vitet 50 -56.</li><li>- Lëvizjet amatore në koreografinë shqiptare përgjatë viteve 50- 90.</li><li>- Themelimin e Filarmonisë së Shtetit Shqiptar.</li><li>- Spektaklin koreografik “Vëllazërimi i popujve”</li><li>- Baletin e parë i vënë në skenën tonë “<i>Shatërvani i Bacisarajt</i>”.</li><li>- Zhvillimet koreografike (vitet '90).</li></ul>
<b>Krijimi i institucioneve arsimore dhe artistike</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Krijimin e Teatrit të Operës dhe të Baletit.</li><li>- Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe i Valleve Popullore.</li><li>- Shkollat e baletit shqiptar.</li></ul>
<b>Baleti shqiptar pas viteve 1950 - 2000</b>	<i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton zotëron dhe vlerëson përmes njohurive</i>

	<p><i>të mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Fadeta”, “Laurencia”, “Sherezade”.</li> <li>- Themeluesit e Shkollës Kombëtare të Baletit</li> <li>- Paganini” dhe “Franceska da Rimini”.</li> <li>- Baletin e parë shqiptar “Halili dhe Hajria”. Baleti “Delina”.</li> <li>- Baletin “Cuca e Maleve”. Baleti “ Tokë e pamposhtur”.</li> <li>- Baletin “Shota e Azem Galica”. Baleti “Plaga e 10-të e Gjergj Elez Alisë”.</li> </ul>
<p><b>Përfaqësuesit e baletit shqiptar</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Panajot Kanaçi, babai i koreografisë shqiptare.</li> </ul> <p>Nxënësi/ja përshkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizën e krijimtarisë së tij në AKVP.</li> <li>- Agron Aliaj, balerini dhe koreografi me kontribute të mëdha.</li> <li>- S. Selimi jeta dhe veprimtaria artistike.</li> <li>- Gëzim Kaceli dhe krijimtaria e tij si pjesë e fondit të artë të AKVP.</li> <li>- Baleti shqiptar i Kosovës.</li> <li>- Angjelin Preljocaj, koreografi me origjinë shqiptare.</li> <li>- Yjet e baletit shqiptar të njohur në skenat ndërkombëtare</li> </ul>
<p><b>Udhëzime metodologjike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkime të informacioneve më të thelluara për vepra skenike.</li> <li>- Kërkime për njohjen më të mirë të kërcimit në gjysmën e dytë të shek. XX në Shqipëri nëpërmjet takimeve dhe bisedave me veteranë të baletit.</li> <li>- Kërkime në galeri arti për lidhjen e arteve të bukura me kërcimin.</li> </ul>	

*Rekomandime* për metodologjinë e zbatimit të programit:

- Prezantimi dhe ilustrimi me DVD gjatë procesit mësimor i baletëve të përfshira në program.
- Shikim i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare të dansit në vendin tonë.

**Udhëzime për vlerësimin:**

- shpjegon *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik shqiptar dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga vitet 50 të shek. XX deri në ditët e sotme;
- analizon veprat (baletet) shqiptare;
- kategorizon baletet sipas periudhave;
- përcakton temat që u trajtuan në baletet shqiptare nga koreografët ;
- vlerëson duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme koreografike

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Arkiva e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit

**Dega: BALET**

**Lënda: Folklor shqiptar**

**Klasa: 10**

<b>Tematika</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi</b>	<i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton, shpjegon dhe vlerëson përmes njohurive të mëposhtme:</i>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarjen etno-koreografike.</li> <li>- Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi.</li> <li>- Lirikën kombëtare të pasqyruar në valle sipas trevave etnike.</li> <li>- Tematikat specifike të fushave që përmbajnë gjininë në koreografi</li> <li>- Karakterin e valles lirike shqiptare.</li> <li>- Emërtimin shqiptar <i>valle</i>.</li> <li>- Forcën ndikuese të valles sonë në vendet fqinje.</li> <li>- Strukturat e ndërtimit arkitektonike të valles lirike shqiptare.</li> <li>- Format e kërcimit popullor.</li> <li>- Specifikat e shoqërimit muzikor në valle.</li> </ul>
<b>Vallet e punës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vallet e gjuetisë.</li> <li>- Vallet e prodhimtarisë.</li> <li>- Vallet e zanatit.</li> </ul>
<b>Koreografia idilike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vallet e dashurisë</li> </ul>
<b>Vajtimet në koreografi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vallet mortore labe.</li> <li>- Gjama e vdekjes.</li> </ul>
<b>Komikja në koreografi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vallet humoristike.</li> <li>- Vallet groteske.</li> <li>- Vallet satirike</li> </ul>

<p><b>Koreografia rituale</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vallet rituale pagane.</li> <li>- Vallet rituale kristjane.</li> <li>- Vallet rituale te dasmave.</li> </ul>
<p><b>Epika në koreografi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Karakteristikat e epikës në koreografi.</li> <li>- Vallet luftarake.</li> <li>- Vallet e rënda.</li> <li>- Vallet dyshe</li> <li>- Vallet treshe</li> </ul>
<p><b>Udhëzime metodologjike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për vallet popullore.</li> <li>- Kërkime për njohjen më të mirë të karakteristikave të epikës në koreografi .</li> <li>- Kërkime në institutin e folklorit për lidhjen e arteve të bukura me kërcimin.</li> </ul> <p><i>Rekomandime për metodologjinë e zbatimit të programit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi dhe ilustrimi me DVD gjatë procesit mësimor i valleve të përfshira në program.</li> <li>- Shikim i shfaqjeve të Ansambllit popullor në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare të dansit në vendin tonë.</li> </ul>	
<p><b>Udhëzime për vlerësimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon zhvillimin e folklorit koreografik në tërësinë e tij dhe në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si: <i>karakterin, mënyrat e të kërcyerit sipas llojeve, ritmet, kostumet popullore</i> që përbëjnë folklorin tonë koreografik;</li> <li>- gjen shembujt folklorikë koreografikë përmes interpretimit, ritmeve, melodive, karaktereve, duke shpjeguar <i>qartë</i> rrugët e</li> </ul>	

krijimit;

- zhvillon aftësitë duke rritur interesin në vallet folklorike, si dhe duke shpjeguar *saktë* tiparet e valleve, karakterin folklorik etj.;
- trajton vlerat e folklorit koreografik;
- jep shpjegime duke sjellë shembuj konkretë të folklorit koreografik nga treva të ndryshme.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Folklori koreografik shqiptar S. Selimi

**Dega: BALET**

**Lënda: Histori baletit botëror**

**Klasa: 11-12**

<b>Tematikat klasa 11</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>
<b>Dansi dhe baleti</b>	<i>Nxënësi/ja në përfundim njeh, demonstroi, zbaton, shpjegon dhe vlerëson përmes njohurive të mëposhtme:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- Kërcimin si gjuha e trupit.</li><li>- Burimet materiale të kërcimit.</li><li>- Elementet dhe parimet themelore të kërcimit.</li><li>- Kërcimin natyra dhe shoqëria.</li></ul>
<b>Periudha Parahistorike</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kërcimin parahistorik.</li><li>- Kërcimin në Egjiptin e lashtë dhe në Orientin e largët.</li></ul>
<b>Kërcimi në botën antike</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kërcimin në periudhën e antikitetit Grek.</li></ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet e kërcimeve në Greqinë Antike</li> <li>- Kërcimin në periudhën e Romës antike.</li> <li>- Llojet e kërcimeve në Romën antike</li> </ul>
<b>Kërcimi në periudhën e Mesjetës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mesjeta dhe kërcimi</li> <li>- Kërcimi Fetar dhe i shenjtë</li> <li>- Kërcimet e Oborrit</li> <li>- Llojet e kërcimeve</li> </ul>
<b>Rilindja e hershme</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet e kërcimeve në Romën antike Rilindja Evropiane dhe kërcimi.</li> <li>- Humanizmi. Studimi mbi kërcimin, struktura dhe teoria</li> <li>- Kërcimi i oborrit. Kërcimet e ulëta dhe të larta</li> <li>- Llojet e kërcimeve Kërcimtarët e oborrit</li> <li>- Kërcimi në Francë Kërcimi në Spanjë dhe Itali</li> </ul>
<b>Kërcimi dhe baleti në shekullin e XVI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërcimi social në Evropë në vitin 1500.</li> <li>- Kërcimi social në Itali Kërcimi social në Francë</li> <li>- Ballot dhe baleti ne traktatin e Karozos dhe Negrit.</li> <li>- Komedia e Artit. Personazhet e Komedisë së Artit</li> <li>- Lindja e baletit ne oborrin Italian.</li> <li>- Baleti në oborrin Francez. Baleti i parë. Baltazar.</li> <li>- Balet i maskave dh anti maskave në Angli.</li> <li>- Koreografët dhe teoricienët e epokës.</li> </ul>

<p><b>Baleti, kërcimi social dhe teatral në shekullin e XVII</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Repertori koreografik dhe muzikor në vitet e para të shekullit të XVII</li> <li>- Kërcimi dhe gjesti në melodramat e fillimeve të viteve 1600. Baleti Melodramatik.</li> <li>- Baleti dhe kërcimi aristokrat në oborrin e Mbretit të Diellit.</li> <li>- Epoka e Luli dhe Moljer</li> <li>- Krijimi i Akademisë mbretërore të kërcimit dhe lindja e koreografisë.</li> <li>- Kërcimet e shekullit XVII(Alemande,Sarabande, Curante Gigue)</li> <li>- Kërcimi teatral në Itali dhe në Francë.</li> </ul>
<p><b>Harta e përgjithshme e baletit në fund të shekullit të XVII dhe fillim të shekullit të XVIII</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërcimi në Operan e Parisit nga koha e Luigjit të XIV deri në kohën e Luigjit të XV.</li> <li>- Prezantimi dhe afirmimi i kërcimit Francez në Evropë.</li> <li>- Kërcimi Italian në Itali dhe në Perëndim.</li> <li>- Baleti anglez.</li> <li>- Rizbulimi i teatrit antik në fillim të shekullit.</li> <li>- Kërcimi kundrejt komunikimit ekspresiv. Prevost, Salle, Camargo</li> <li>- Kërcimet e shek XVIII(minueti, gavota, romaneska,etj)</li> <li>- Shkolla e baletit të operas kombëtare të Parisit</li> </ul>
<p><b>“ Baleti Veprues”Epoka e Noverit.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koreografët, artistët e baletit dhe kompozitorët e baleteve në Evropë.</li> <li>- Ramo dhe akademizmi i baletit. Estetika e shfaqjeve franceze.</li> <li>- Reformat e Hilverding në Vjenë. Baletet e tij.</li> <li>- Kërcimi në Itali.</li> <li>- “Baleti i Pantomimës” i Jean – Baptiste de Hesse.</li> <li>- Pre- baletet veprues në Francë</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Familja Vestri</li> <li>- Maximilian dhe Pierre Gardel</li> <li>- Debati estetik. Kërcimi si një art imitimi.</li> <li>- Reformat e Jean – Georges Noverre.</li> <li>- Baletet dhe bashkëpunëtorët e Noverit.</li> <li>- Reforma e Gasparo Angiolini. Baletet e tij.</li> <li>- Polemikë midis Angiolinit dhe Nover.</li> <li>- Evolimi i teknikës Akadematike franceze. Reforma e dytë në baletin francez.</li> <li>- Jean Dauberval. Baleti Kujdesi i kote</li> </ul>
<b>Baleti pre- romantik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koha dhe stili i kërcimit francez.</li> <li>- Baletet pre- romantike.</li> <li>- Karlo Blasis, teoricien i baletit pre- romantik.</li> <li>- Kërcimi italian midis neoklasicizmit dhe romantizmit.</li> <li>- Koreodrama e Salvatore Vigano. Baletet e tij.</li> <li>- Charl Lui Didlo dhe baletet e tij</li> </ul>
<b>Baleti romantik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ëndrra dhe realiteti i baletit romantik.</li> <li>- Koreografët, kompozitorët dhe balerinët e romantizmit.</li> <li>- Baletet romantike. Veçoritë e tyre.</li> <li>- Baleti romantik në Francë, Danimarkë dhe Itali.</li> <li>- Baleti “Silfidë”, “Zhizel”, “Korsar” " Pas de Quatre""Paquita"</li> <li>- Kërcimet e shek XIX ( Vals, Polonez, Kadril, Polka, Mazurka, Kotiljon )</li> </ul>

<p><b>Baleti evropian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literatura e kërcimit në gjysmën e parë të shekullit të XIX.</li> <li>- Baleti francez, anglez.</li> <li>- Baleti Kopelia</li> <li>- Baleti italian, danez.</li> </ul>
<p><b>Tematikat klasa 12</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>
<p><b>Baleti rus në shek XIX</b></p>	<p><i>Nxënësi/ja në përfundim njej, demonstroi, zbaton, shpjegon dhe vlerëson përmes njohurive të mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Charl Didlo në formimin e teatrit të baletit rus. Romantizmi në baletin rus.</li> <li>- Artur Sen – Leon dhe reformi i baletit rus.</li> <li>- Historikun e puantes</li> <li>- Marius Petipa dhe teatri i baletit në gjysmën e dytë të shekullit XIX.</li> <li>- Lindjen e baletit simfonik. Artistët më të mirë të baletit rus.</li> <li>- Baletet “Arrëthyesi”, “Liqeni Mjellmave”, “Bukuroshja e Fjetur”, “E bija e faraonit”, “Rajmonda”.</li> <li>- Marinski Teater</li> <li>- Format e baletit klasik;</li> </ul>
<p><b>Sezonet ruse</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sezonet ruse dhe S. Djailjev. Sezoni i parë rus.</li> <li>- Koreografi M.Fokin Baletet e dhe bashkëpunëtorët e tij.</li> <li>- Ana Pavlova dhe Bronisllava Nizhinskaja</li> <li>- Sezoni i dytë rus. Artistët më të rëndësishme të këtij sezoni.</li> <li>- Koreografët e sezonit të dytë dhe baletet e tyre më të rëndësishme.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sezoni i tretë rus. Artistët më të rëndësishëm të këtij sezoni.</li> <li>- Koreografët e sezonit të tretë dhe baletet e tyre më të rëndësishme.</li> <li>- Balanchine dhe baletet e tij.</li> </ul>
<b>Baleti në Europë dhe Amerikë në shekullin e XX</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Baleti në Francë. Opera e Parisit</li> <li>- Baleti në Angli.( Ninette de Valois; Alicia Markova)</li> <li>- Maria Rambert, Frederic Ashton,</li> <li>- Marius Bezhar dhe Bolero</li> <li>- Jerome Robbins</li> <li>- Royal Ballet</li> <li>- Baleti në Amerikë. Baleti modern në Evropë dhe në Amerikë</li> </ul>
<b>Kërcimi modern</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërcimi modern në Amerikë: <i>Martha Graham, Jose Limon, Doris Humphrey.</i></li> <li>- Kërcimi xhaz dhe pionierët e tij në Amerikë.</li> <li>- Avangardët e rinj amerikanë: <i>Aë Halprin, Merce Cuëingham, Murray Louis.</i></li> </ul>
<b>Baleti në RUSI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arritjet e baletit sovjetik nga revolucioni deri në vitet '60.</li> <li>- Artistët më të mirë të artit koreografik sovjetik.</li> <li>- Baletet më të rëndësishme</li> <li>- Agripina Vaganova dhe metoda Vaganova</li> <li>- Maria Semyonova, Galina Uljanova</li> <li>- Maya Plitceskaya, Natalia Makarova</li> <li>- Vladimir Vasiliev, Ekaterina Maksimova</li> <li>- Tiparet e koreografisë sovjetike dhe arritjet e reja mbas viteve '60.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grigorovich dhe baletet e tij</li> </ul>
<b>Kërcimi kontemporan</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërcimi post modern. Trisha Broën</li> <li>- Danc teatër., <i>Pina Bausch.</i></li> <li>- Kërcimi i ri: <i>Angli, Francë</i></li> <li>- Margotte Fonteyn, Rudolf Nureyev, John Cranco</li> <li>- Keneth MacMillan, Ëilliam Forsythe, Mikhail Barashnikov, Natalia Makarova</li> <li>- Metodatat e baletit</li> <li>- Kompanite e baletit</li> <li>- Sylvie Guillem</li> <li>- Darcey Busell, Jiri Kylian, John Neumeier</li> <li>- Nacho Duato, Alicia Alonso, Matc Ek</li> <li>- Carlo Acosta, Tamara Rojo, Roberto Bolle dhe Aleksandra Ferri</li> <li>- Zakharova, Lopatkina' Alina Cojocar</li> <li>- Misty Copland, Marianela Nunez, Vasil Vasieliev Osipovva</li> </ul>
<b>Udhëzime metodologjike:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkime nëpërmjet internetit të informacioneve më të thelluara për vepra skenike të pasqyruara në ëbsite të ndryshme apo në YouTube.</li> <li>- Kërkime për njohjen më të mirë të kërcimit në parahistori dhe antikitet nëpërmjet zbulimeve arkeologjike .</li> <li>- Kërkime në galeri arti për lidhjen e arteve të bukura me kërcimin.</li> </ul>	
<b>Udhëzime për vlerësimin:</b>	

- Shpjegon *shumë qartë* zhvillimin e artit koreografik botëror dhe përcakton etapat kryesore të koreografisë nga parahistoria deri në ditët e sotme.
- Analizon *shumë saktë* veprat (baletet) botërore.
- Kategorizon *saktë* baletet sipas periudhave.
- Përcakton *saktë* gjinitë e kërcimit nga ai klasik apo dëmi klasik.
- Vlerëson *saktë* duke mbajtur qëndrim ndaj veprave të ndryshme të huaja koreografike.

**Materiale dhe burime mësimore:**

- Prezantimi dhe ilustrimi me DVD gjatë procesit mësimor i baleteve të përfshira në program.
- Shikim i shfaqjeve të baletit në TKOB, Akademinë e Arteve të Bukura, si dhe në festivale ndërkombëtare të dansit në vendin tone
- The story of ëorld ballet, K.V. Burian
- The story of Ëorld ballet
- Ballet, the definitive illustrated story, Viviana Durante
